Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

01-020/01-0041373/26
02.10.2026

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assambly

Në bazë të nenit 11 dhe 12 paragrafi 2, shkronja d), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshëm të Komunës, neni 18 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunë dhe neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d) i Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullte të mbajtur me datë 29.09.2026, mori këtë:

V E N D I M

(Për formimin e komisionit të ankesave)

Neni 1

Miratohet propozim-vendimi Nr.02-020/01-0039407/26, i datës; 11.09.2026, Për formimin e komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzime afatgjatë dhe afatshkurtër të pronave së paluajtshme Komunale.

Neni 2

Komisioni i ankesave, formohet në këtë përbërje prej (5) pesë anëtareve:

1. **Besarta Meha Ademi** , anëtare nga ekzekutivi;
2. **Enver Çerkini** , anëtar nga ekzekutivi;
3. **Alban Berisha** , anëtar nga Kuvendi;
4. **Abdullah Gashi** , anëtar nga Kuvendi, dhe
5. **Gentiana Zeqiri**, anëtarë nga shoqëria civile.

Neni 3

Mandati i komisionit të ankesave është dy (2) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës. Vendimi për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të komisionit aprovohet në Kuvendin e Komunës me shumicën e votave të anëtarëve prezent dhe që votojnë.

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësitë Komisionit të ankesave janë: të përcaktuara në Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunë, si Pranimi i ankesave të paraqitura në vlerësimin e ofertave, shqyrtimi i ankesave, njoftim me vendim të marr Kryesuesin e Kuvendit dhe Kryetarin e Komunës,

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset; Komisioni i ankesave të cekur si me lartë, nën mbikëqyrje të Kryetarit të Komunës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit te tij ne ueb – faqen të Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

1. Anëtarëve të Komisionit,
2. MAPL-së,
3. Zyrës së Kryetarit,
4. Arkivit,
5. Dosjes.

KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Shaqiri-Kelmendi

DALESE - IZLAZNA - OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-645/10
Data 28.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administartion

Për:	**Sami Lushtaku**, Kryetar i Komunës së Skenderajt **Adelina Spahiu Alija**, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	**Elbert Krasniqi**, Ministër i MAPL-së **Jeton Qela**, Sekretar i Përgjithshëm të MAPL	
Nga:	**Erblin Hetemi**, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 14.10.2026 VI-020-645
Zyrtaret përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	**Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit **Donjeta Cakolli**, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve të Komunës	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimi nr.01-020/01-0041373/26 për formimin e komisionit të ankesave
I miratuar më datë: 29.09.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.10.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me legjislacionin në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur me datë 29.09.2026, ka miratuar, **vendimi nr.01-020/01-0041373/26 për formimin e komisionit të ankesave.**

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt, është bazuar në nenin 12, të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), në nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (GZ e Republikës së Kosovës nr. 10/03 Prill 2019), nenin 18, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Vendimi është miratuar me 18 vota për, 2 kundër dhe 0 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me këtë vlerësim.